



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri: KSC-BC-2020-06/IA009

Vendosi: Kryetarja e Dhomave të Specializuara
Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 27 korrik 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit për Shqyrtimin e
Kërkesave lidhur me Afatet**

Gjykatësve të Panelit të Gjykatës së Apelit:

Gjykatëse Mishelë Pikar

Gjykatës Emilio Gati

Gjykatëse Nina Jorgensen

Mbrojtësit të Hashim Thaçit:

Gregori Kihou

Mbrojtësit të Kadri Veselit:

Ben Emerson

Zyrës së Prokurorit të Specializuar:

Xhek Smith

Mbrojtësit të Rexhep Selimit:

Dejvid Jang

Mbrojtësit të viktimave:

Sajmon Loz

Mbrojtëses së Jakup Krasniqit:

Venkatesvari Alagenda

KRYETARJA e Dhomave të Specializuara ("Kryetarja"), duke vepruar në bazë të neneve 33(1)-(3), dhe 45(2) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji"), rregullave 2, 9(5), 13, 97(3), 169 dhe 170(1) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja") dhe rregullave 3 dhe 4 të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve të Dhomave të Specializuara nga Regjistri i Gjykatësve Ndërkombëtarë ("Rregullorja për Caktimin e Gjykatësve"), me anë të këtij vendimi cakton një panel të Gjykatës së Apelit për të vendosur lidhur me kërkesat e: (i) z. Hashim Thaçi, z. Rexhep Selimi dhe z. Jakup Krasniqi ("Kërkesa e Parë");¹ (ii) z. Kadri Veseli ("Kërkesa e Dytë");² dhe (iii) Zyrës së Prokurorit të Specializuar ("ZPS", përkatësisht "Kërkesa e ZPS-së")³ (bashkërisht "Kërkesat") për zgjatjen e afatit për apelimin e Vendimit të Gjykatës të Procedurës Paraprake mbi Mocionet që Ngrenë Kundërshtime lidhur me Juridiksionin e Dhomave të Specializuara ("Vendimi mbi Juridiksionin").⁴

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 22 korrik 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nxori Vendimin mbi Juridiksionin, në të cilin miratoi pjesërisht disa aspekte të kundërshtimeve të ngritura, dhe rrëzoi pjesën tjetër të kundërshtimeve të ngritura nga të akuzuarit në këtë çështje gjyqësore.⁵

¹ IA009/F00001, Kërkesë e Mbrojtjes së Selimit, Krasniqit dhe Thaçit për Zgjatjen e Afatit për Dorëzimin e Apeleve kundër Vendimit të Gjykatës të Procedurës Paraprake mbi Mocionet Paraprake, 23 korrik 2021.

² IA009/F0002, Kërkesë e Mbrojtjes së Veselit për Ndryshimin e Afatit për Apelimin e Vendimit KSC-BC-2020-06/F00142 (Vendim mbi Mocionin që Ngrenë Kundërshtime lidhur me Juridiksionin e Dhomave të Specializuara), 26 korrik 2021.

³ IA009/F0003, Kërkesë e Prokurorisë për Zgjatjen e Afateve, 26 korrik 2021.

⁴ F00412, Vendim mbi Mocionet që Ngrenë Kundërshtime lidhur me Juridiksionin e Dhomave të Specializuara, 22 korrik 2021.

⁵ Shih Vendimin mbi Juridiksionin, para. 214.

2. Më 23 korrik 2021, z. Thaçi, z. Selimi dhe z. Krasniqi dorëzuan Kërkesën e Parë.⁶

3. Më 26 korrik 2021, z. Veseli dorëzoi Kërkesën e Dytë⁷ dhe ZPS-ja dorëzoi Kërkesën e ZPS-së.⁸

II. DISKUTIM

4. Të gjitha Kërkesat kanë të bëjnë me zgjatjen e afatit lidhur me apelet e Vendimit mbi Juridiksionin. Rrjedhimisht, të gjitha Kërkesat do të trajtohen në këtë vendim.

5. Në Kërkesën e Parë, z. Thaçi, z. Selimi dhe z. Krasniqi argumentojnë se pushimi veror i Gjykatës “është planifikuar të fillojë më 24 korrik 2021 dhe të zgjasë deri më 15 gusht 2021”, dhe duke pasur parasysh “rrethanat e jashtëzakonshme” të shkaktuara nga pandemia e KOVID-19, “pezullimi efektiv i afateve për një periudhë të shkurtër përgjatë kësaj periudhe” përligjet, në mënyrë që të dorëzojnë apelet e tyre kundër Vendimit mbi Juridiksionin.⁹ Për këto arsye, z. Thaçi, z. Selimi dhe z. Krasniqi i kërkojnë Kryetares “të gjejë arsye të vlefshme [...] për ndryshimin e afatit dhe të urdhërojë që apelet kundër [Vendimit mbi Juridiksionin [...]] të dorëzohen deri të premtën, 27 gusht 2021”.¹⁰

6. Krahas sa më lart, z. Veseli kërkon “ndryshim të afatit” për dorëzimin e apelit kundër Vendimit mbi Juridiksionin, me argumentin se vendimi i ardhshëm i Gjykatësit të Procedurës Paraprake mbi mocionin e tij që ngre çështje kushtetuese është i ndërlidhur me Vendimin mbi Juridiksionin.¹¹ Për këtë arsye, z. Veseli kërkon që Kryetarja “të ndryshojë afatin për apelimin e [Vendimit mbi Juridiksionin] për t’i mundësuar Mbrojtjes që të paraqesë pikat e apelit brenda [dhjetë] ditësh nga marrja e

⁶ Shih në përgjithësi Kërkesën e Parë.

⁷ Shih në përgjithësi Kërkesën e Dytë.

⁸ Shih në përgjithësi Kërkesën e ZPS-së.

⁹ Kërkesa e Parë, para. 7.

¹⁰ Kërkesa e Parë, para. 8.

¹¹ Kërkesa e Dytë, para. 6-7.

njoftimit për vendimin mbi kundërshtimet kushtetuese, i cili ende nuk është lëshuar, dhe jo më herët se 27 gushti 2021”.¹²

7. Së fundi, edhe ZPS-ja kërkon zgjatje të afatit për apelimin e Vendimit mbi Juridiksionin “deri në dhjetë ditë pas marrjes së njoftimit për vendimin mbi disa kundërshtime kushtetuese, ose deri më 27 gusht 2021, cilado datë që është e mëvonshme”.¹³ Gjithashtu, ZPS-ja nuk kundërshton zgjatjen e afateve të kërkuar nga të akuzuarit dhe kërkon që në rast të miratimit të kërkesave të tyre, edhe ZPS-së t’i miratohet ‘zgjatje proporcionale afati – përkatësisht deri më 30 shtator 2021’.¹⁴

8. Në këtë kontekst, Kryetarja rikujton nenin 32(3) të Ligjit, sipas të cilit Kryetari “është përgjegjës për administrimin gjyqësor të Dhomave të Specializuara dhe për funksionet e tjera që i ngarkohen atij me këtë Ligj.” Një nga funksionet kryesore administrative të Kryetarit në bazë të nenit 33(1)-(3) të Ligjit dhe rregullës 13(1)(c) të Rregullores është të caktojë gjykatësit në panele gjyqësore për të shqyrtuar parashtrimet e palëve dhe për të nxjerrë vendimet përkatëse.

9. Sipas rregullës 9(5) të Rregullores, “nëse i tregohen arsye të vlefshme, ose *proprio motu*, paneli mund: (a) të zgjasë ose shkurtojë afatet e përcaktuara prej kësaj Rregulloreje apo prej panelit [...]”. Rregulla 2 e Rregullores e përkufizon panelin si “cilido panel/trup gjykues, ose gjykatës, i caktuar në një çështje në përputhje me nenin 25(1) dhe nenin 33 të Ligjit, përveç nëse është përcaktuar ndryshe”. Rrjedhimisht, është e qartë se vendimi mbi një kërkesë për zgjatjen e afateve është ekskluzivisht kompetencë e një paneli të caktuar. Në këtë rast, paneli duhet të jetë një panel i Gjykatës së Apelit.

10. Sipas nenit 33(1)(c) të Ligjit, paneli i Gjykatës së Apelit duhet të caktohet “sapo të paraqitet parashtrësia për ankesë të ndërmjetme në lidhje me ndonjë vendim të

¹² Kërkesa e Dytë, para. 8. Shih edhe Kërkesa e Dytë, para. 9.

¹³ Kërkesa e ZPS-së, para. 1.

¹⁴ Kërkesa e ZPS-së, para. 1.

gjyqtarit të procedurës paraprake ose të trupit gjykues sipas së drejtës nga neni 45(1) [...]”. Gjithashtu, rregulla 169 e Rregullores parasheh se “ [n]ë bazë të nenit 33(1)(c) të Ligjit, Kryetari cakton një panel të Gjykatës së Apelit pas paraqitjes së kërkesës për apel të ndërmjetëm të dorëzuar në bazë të së drejtës së vetvetishme, [...] ose sikurse mund ta lypë nevoja”.

11. Të akuzuarit dhe ZPS-ja nuk i kanë dorëzuar ende apelet e tyre kundër Vendimit mbi Juridiksionin. Sidoqoftë, duke pasur parasysh rëndësinë e marrjes së vendimit mbi Kërkesat *sub judice* para përfundimit të afatit të paraparë në rregullën 170(1) të Rregullores, Kryetarja e gjykon të nevojshme të caktojë një panel të Gjykatës së Apelit, në përputhje me formulimin në fund të rregullës 169 të Rregullores.

III. CAKTIMI

12. Pas shqyrtimit të kriterëve të parashikuara në rregullën 4 të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve, duke përfshirë përvojën dhe kompetencën përkatëse, si edhe disponueshmërinë në këtë moment,

KRYETARJA ME KËTË VENDIM CAKTON:

Gjykatësen Mishelë Pikar

Gjykatësin Emilio Gati

Gjykatësen Nina Jorgensen

në panelin e Gjykatës së Apelit për të vendosur në lidhje me Kërkesat.

/nënshkrimi/

Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

Kryetare e Dhomave të Specializuara

E martë, 27 korrik 2021

Në Hagë,

Holandë